



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë.

E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 1267/____ Prot.

Tiranë, më 26.07.2019

V E N D I M

Nr. 18, Datë 26.07.2019

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË KURBIN “MBI AUDITIMIN E
PËRPUTHSHMËRISË”
(Për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2018)**

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Kurbin, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit janë materiale (jo të përhapura), efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar. Fusha kryesore të cilat janë konstatuar gabime është në planifikimin dhe realizimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, në menaxhimin e pronës (aseteve), në procedurat e prokurimeve me fondet buxhetore dhe zbatimit të kontratave të punimeve.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit në Bashkinë Kurbin sipas programit të auditimit nr. 1267/1prot, datë 21.11.2018, për periudhën 01.01.2016 - 31.12.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni mbi përputhshmërinë (i kualifikuar¹):

Nga auditimi mbi përputhshmërinë²sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti, Bashkia Kurbin, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), u evidentuan në përgjithësi zbatimi tyre, por ne disa raste devijimeve nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “*Bazës për Opinionin e Kualifikuar*”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale (jo të përhapura).

Baza për opinionin e kualifikuar:

- *Në fushën e procedurave të prokurimit*, për periudhën objekt auditimi 01.01.2016 – 31.12.2018 janë kryer gjithsej 66 procedura me vlerë të fondit limit prej 868,875,846 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 833,969,980 lekë ose 96% e vlerës së fondit limit. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i auditimit auditoi me zgjedhje 39 procedura me vlerë kontrate të lidhur prej 550,455,653 lekë ose 89% e vlerës së kontratave, dhe në totalin e procedurave të audituara, rezultoi se në 9 procedura me vlerë kontrate prej 66,238,200 lekë ose 12 % e kontratave të audituar, janë konstatuar parregullsi, në përcaktimin e kriterëve jo në përputhje me procedurën dhe zërat e preventivit, dhe në kushtet e paligjshmërisë së shpalljes fitues të operatorëve në vlerën 2.8 milionë lekë.

- *Në zbatimin e kontratave të punimeve*, nga 26 procedura të zhvilluara në fushën e investimeve me vlerë kontrate 453,130 mijë lekë (*periudha 01.01.2016 – 31.12.2018*), me zgjedhje janë audituar zbatimi i punimeve për 5 kontrate me vlerë 179,450 mijë lekë ose 39.6% e kontratave të lidhura, duke evidentuar dëm ekonomik në vlerën 1.2 milionë lekë.

- *Në fushën e menaxhimit të aseteve*, u konstatua mos lidhje e kontratave për shfrytëzimin e fondit pyjor/kollusore nga subjekte me leje shfrytëzimi nga MEI, për sipërfaqen 107.2 ha, që përbëjnë të ardhura të munguara për vlerën 141 milionë lekë;

- *Në fushën e administrimit të të ardhurave vendore*, u konstatua mos aplikim të saktë të taksës së hidrokarbureve në vlerën 5.6 milionë lekë dhe mos administrimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje (ALUIZNI), në vlerën 28.5 milionë lekë;

Mos zbatimin e dispozitave ligjore për arkëtimin e borxhit nga taksat e tarifave vendore në vlerën 107 milionë lekë, si dhe mos zbatim të rekomandimeve të lëna nga auditimet e KLSH, kryesisht të masave shpërblim dëmi në vlerën 10 milionë lekë, etj.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë.

Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar në procedurat e prokurimit. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç

¹Sipas Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së, kapitulli V pika 5.4, Konkluzionet/opinionet e kualifikuar: Audituesi shpreh një konkluzion me reserve kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështje, nuk janë aq material sa të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit. Kur auditimi i përputhshmërisë kryhet së bashku me pasqyrat financiare, audituesi mund të shpreh një opinion me rezervë kur devijimet janë material por jo të përhapura, ose n.q.s audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencë auditimi të përshtatshme dhe, efektet e mundshme janë material por jo të përhapura.

²ISSAI 4100– Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

ISSAI 4200- Objektivi i audituesit në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kundrinë ligjorë dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me auditivën e pasqyrave financiare.

standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2017, konstatohet se:

Llogaria 219- *“Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”* është ngarkuar padrejtësisht për vlerën 28,774,375 lekë, pasi është llogaritur amortizim dhe për objekte (investime), të cilat nuk janë mbyllur akoma me akt-kolaudim përfundimtar, duke mos i klasifikuar në llogarinë 231- *Shpenzime proces për rritjen e AQT*”, vlerën e punimeve të pambyllura prej 429,528,988 lekë.

Llogaria 202 *“Studime e projekte”*, paraqitet në vlerën 39,865,600 lekë, ku konstatohet se 15 projekteve me vlerë 14,004,680 lekë (*sipas pasqyrës aknes A/3.2.5, bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit*), i përkasin investimeve për objekte të përfunduara, duke mos i klasifikuar si Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara. Disa nga projektet nuk kanë emërtim dhe nuk mund të evidentohet nëse janë vënë në zbatim ose jo (për ish- Bashkinë Mamurras dhe ish- Komunën Milot), dhe nga Bashkia Kurbin nuk është marrë asnjë masë për të saktësuar projektet e trashëguara në lidhje me emërtimin e tyre dhe sa nga këto janë vënë në zbatim.

Veprimet e mësipërme bien ndesh me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”*; UKM nr. 2, datë 08.05.2003 *“Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *“Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”*, pjesa e parë, *“Rregulla të përgjithshme”* kapitulli i parë *“Mbajtja e kontabilitetit”* (*Gjerësisht trajtuar në pikën (A) faqe 26-28, të Raportit Përfundimtar dhe pasqyrën aneks A/1, bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat që për objektet të cilat janë në proces dhe të pa marrë në dorëzim me akt-kolaudim përfundimtar të kontabilizohen në llogarinë 231- *Shpenzime proces për rritjen e AQT*, dhe jo në llog. 212-*Ndërtime e konstruksione* apo llog. 213-*Rrugë, rrjete, vepra ujore*.

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llog. 202 *“Studime e projekte”*, në mënyrë që në këto llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve të investimeve të cilave nuk kanë përfunduar.

2.3. Rekomandimi: Drejtoria e financës (sektori i kontabilitetit), të marrë masa që për projektet e mbetura të ish- bashkive/komunave, të evidentojnë llojin e projektit, vitin e hartimit dhe nëse këto projekte janë vënë në zbatim ose jo.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2019

2. Gjetje nga auditimi: Faturat e palikuiduara në fund të vitit 2018 paraqitet në vlerën 40,994,860 lekë të cilat zënë 7.9 % të fondeve të buxhetit (*sipas pasqyrës Aneks A.3.2/b.1, bashkëlidhur Raport Auditimit*), ku vlerën më të lartë e zë detyrime nga Shoqata e të Verbërve në vlerën 11,427,199 lekë ose 27.8%, për pagesat e pasakta (zbatimi vendimit gjyqësor nr. 1490, datë 20.3.2016 me nr. Akti 6215 dhe vendim Gjykatë apeli nr. 8982/4040, datë 15.5.2018 dhe nr. Akti 13760, që Shoqata e të Verbërve ka fituar me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale).

Arsyeja e mos kryerjes së pagesave të faturave, është se një pjesë e tyre janë të ish- komunave për të cilat dokumentacioni shoqëruar nuk është i saktë, ndërsa pjesa tjetër është mos financimet e kryera

nga FZHR dhe bllokimet e fondeve në fund të periudha nga MF të fondeve, veprime në kundërshtim me nenet 40, 50, 52 dhe 54, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" i ndryshuar me UMF nr. 5/1, datë 21.05.2014; Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018 "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91 (*Më hollësisht trajtuar në pikën (A), faqe 28-29, të Raportit Përfundimtar*).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxheteve vjetore, të paraqes një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, si dhe të hartojë grafik për shlyerjen e detyrime në fund të vitit 2018 për vlerën **40,994,860 lekë**, duke ndjekur radhën e pagesave sipas vitit të krijimit.

Të bëjë publikimin e të gjitha detyrimeve të prapambetura në faqen zyrtare të institucionit, dhe të mos planifikojë investime të reja, pa likuiduar detyrimet e faturave të prapambetura.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore, u konstatua se për periudhën objekt auditimi (2016-2018), janë në proces pagese gjithsej 23 vendime për vlerën 35,951,642 lekë, nga e cila për largimet nga puna për 16 punonjës në vlerën 9,377,647 lekë (*nga e cila punonjës me status 3 veta me vlerë 3,829,980 lekë dhe punonjës me kontratë pune 13 veta me vlerë 5,547,667 lekë*), dhe të tjera 7 vendime për vlerën 26,573,995 lekë, detyrimi për vendimet gjyqësore të formës së prerë.

E gjithë shuma për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, është një shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit duke qenë se i përket vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna, ku përfshihet dhe vlera prej 368,799 lekë tarifa përmbarimor, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Aktualisht në proces zbatimi janë vetëm dy vendime gjyqësore për vlerën 16,427,860 lekë, konkretisht vendimi gjyqësor nr. 2910, datë 28.5.2015 të H. R. për shpronësim me vendimi gjykate nr. 1490, datë 20.3.2016 me nr. Akti 6215 dhe vendim Gjykatës Apelit nr. 8982/4040, datë 15.5.2018 dhe nr. Akti 13760 për vlerën 11,427,860 lekë për "Shoqatën e të Verbërve" (*Më hollësisht trajtuar në pikën (A), faqe 32-34, të Raportit Përfundimtar*).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak, të analizojë të gjitha proceset gjyqësore të cilat kanë sjellë ndikim negativ në buxhetin e Bashkisë Kurbin për vlerën **15,583,869 lekë**, duke kërkuar nxjerrjen e përgjegjësisë ligjore ndaj personave shkakhtarë të gjendjes.

Në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak

4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e veprimeve me arkën, u konstatua se janë kryer veprime në paligjshmëri të përdorimit të vlerave të larta (pagesa dhe arkëtime), ku për arkëtimet janë kryesisht arkëtimet nga taksat e tarifave vendore që zënë peshën më të lartë dhe nga vërtetimet e ndryshme, ku për vitin 2016 janë prerë gjithsej 1808 MA për vlerën 29,160,095 lekë, për vitin 2017 janë gjithsej 1736 MA për vlerën 39,943,988 lekë dhe për vitin 2018 janë gjithsej MA për vlerën lekë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin (i azhornuar me ligjin nr. 110/2015 datë 15.10.2015), pikat 63 dhe 64, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve të njësisë së sektorit publik", të ndryshuar dhe VKM nr. 290, datë 14.6.1993 "Për limitin e arkës në ndërmarrjet shtetërore". (*Trajtuar më hollësisht në pikën (B), faqet 30-31, të Raportit Përfundimtar*).

4.1. Rekomandimi: Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nënpunësit Zbatues, të marrë masa për eliminimin e veprime të kryera me arkë mbi limitin e lejuar ligjorë, dhe të bëjë kanalizimin e veprimeve nëpërmjet bankës në lidhje me arkëtimet që realizohen gjatë një viti ushtrimorë, për të eliminuar përdorimin CASH të veprimeve financiare.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit respektimin e dispozitave ligjore mbi inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të materialeve, u konstatua se për periudhën 2016 – 2017 nga Bashkia Kurbin janë ngritur komisionet e inventarizimit dhe kryer procesi i tij, ku në përfundim të procesit për disa materialeve është kërkuar dalje jashtë përdorimit, pasi janë jashtë funksionit dhe kanë humbur vetitë e tyre funksionale, konkretisht për vitin 2016 në vlerën 12,754,996 lekë, nga e cila llog. 214 në vlerën 1,563,227 lekë, llog. 218 në vlerën 4,461,411 lekë dhe llog. 327 në vlerën 6,730,358 lekë. Ndërsa për aktivitetin e vitit 2017 është propozuar vlera 45,215,636 lekë, nga e cila llog. 214 në vlerën 4,470,399 lekë, llog. 218 në vlerën 28,634,984 lekë dhe llog. 327 në vlerën 12,110,253 lekë. Për të dy periudhat nga Kryetari i Bashkisë vlerat janë miratuar në Këshillin Bashkiak dhe Prefektin e Qarkut Lezhë.

Nga ana e komisionit të inventarizimit nuk është bërë i mundur që për materialet e dala jashtë përdorimit, të bëhej një vlerësim i tyre duke evidentuar materialet me përbërje skrap dhe materialet me përbërje druri, për të bërë të mundur përfitimin e vlerave monetare në favor të të ardhurave të bashkisë nga rishitja e tyre. Gjithashtu në procesverbalin e asgjësimit të materialeve nuk është përcaktuar vendi i asgjësimit, mënyra e asgjësimit (*me thyerje, djegie dhe groposje*), nuk është përcaktuar vendi i groposjes së materialeve të asgjësuar, si dhe nuk është bërë sistemimi në kontabilitet, veprime në papajtueshmëri me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin” neni 12 pika 3, neni 16 pika 2, neni 23 pika 5 dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kreu III, pika 35 shkronja c- “*Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve*”, pika 42-50, kreu IV pika 109, neni 73 deri në nenin 106.

Gjithashtu për aktivitetin e vitit 2017, u konstatua se janë propozuar për dalje jashtë përdorimit dhe 7 automjete, nga të cilat 5 automjete në vlerën 6,922,700 lekë janë nxjerr jashtë përdorimit nëpërmjet rishitjes si skrap në vlerën 95,900 lekë, duke mos pasur mundësi rishitje, ndërsa 2 mjete me vlerë 4,392,000 lekë kanë dalë në shitje me procedura ankandi.

Në lidhje me dy mjetet të cilat janë me procedurë shitje (me ankand), megjithëse është zhvilluar dy herë, nuk është realizuar pasi ka dështuar për mospjesëmarrje të subjekteve të interesuara. Nga auditimi i procedurës së ankandit, nuk u konstatuan mangësi ligjore në zbatimin e saj.

Konstatohet se vlera e mjeteve të paraqitura në llog 215- “*Mjete transporti*”, nuk përputhet për shumën 4,932,000 lekë, e cila i korrespondon vlerës së 2 automjeteve të cilat janë dërguar për shitje me procedurë ankand, duke u bërë zbritje padrejtësisht, veprime në kundërshtim me pikat 109 dhe 110 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12 dhe UMF nr. 26, datë 27.12.2007. (*Trajtuar më hollësisht në pikën (A), faqe 38-41, të Raportit Përfundimtar*).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Kurbin të marrë masat që në rastet e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, të bëjë seleksionimin e materialeve të vlerësuar para asgjësimit të tyre me qëllim përfitimin e vlerave materiale nga zberthimi i tyre në dobi të institucionit me natyrë druri dhe hekuri si karrige, tavolina, stola, kazma, lopata, sëpata, çekiç, varëse rrobash, tubo, etj., për të bërë të mundur arkëtimin e të ardhurave në interes të Bashkisë Kurbin.

5.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të marrë masa që vlera e dy mjeteve prej 4,932,000 lekë të pa shitura me procedurë ankand, por të zbritur padrejtësisht nga aktivet, të bëhet rimarrja e kontrollit të tyre deri në përfundim të procesit të shitjes (*Trajtuar më hollësisht në pikën (A), faqet 35-42, të Raportit Përfundimtar*).

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2019

6. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Kurbin, u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, kështu për vitin 2016, në total shpenzimet janë realizuar në masën 48,7% ose nga 667,319 mijë lekë të planifikuara në 325,254 mijë lekë të realizuara. Për vitin 2017, është realizuar në masën 80.9% ose nga 741,798 mijë lekë të planifikuara në 600,849 mijë lekë të realizuara. Për vitin 2018, është realizuar në masën 83% ose nga 513,236 mijë lekë të planifikuara në 426,458 mijë lekë të realizuara. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre, kryesisht për shkak të

mosrealizimit të të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Këshilli i Bashkisë Kurbin nuk ka dokumentuar veprimtarinë e komisionit të financave, i cili vepron gjatë gjithë periudhës së mandatit dhe ka si funksion të kontrollojë të ardhurat dhe shpenzimet e kryera nga organi ekzekutiv, në përputhje me buxhetin e miratuar nga këshilli. Analizat e punës për realizimin e buxhetit paraardhës nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë viteve të audituar (*Trajtuar më hollësisht në pikën B, faqet 41-45, të Raportit Përfundimtar*).

6.1 Rekomandimi: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Kurbin të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me administrimin e taksave e tarifave vendore, u konstatua se:

- Nuk janë bërë rakordimet me ZVRPP Kurbin (sot AKSH), për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, dhe për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, veprime në mos përputhje me nenin 25 “Të ardhurat nga taksat e ndara”, të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pika 2, shkronja(a).

- Dokumentacioni për pagesën e taksës së tokës, nuk ndodhet në Bashki Kurbin, por në Njësitë Administrative përkatëse, veprim në kundërshtim me VKM-në nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial” dhe të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit për Çështjet Vendore dhe Ministrit të Financave nr. 3237, datë 16.7.2015 “Për procedurat, afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial” (*Trajtuar më hollësisht në pikën B, faqet 45-52, të Raportit Përfundimtar*).

7.1. Rekomandimi: Bashkia Kurbin, të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me QKB-në, QKL-në, Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, AKSH-in, për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të merren masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji.

7.2. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Kurbin, të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura.

7.3. Rekomandimi: Bashkia Kurbin me strukturat përgjegjëse, të marrë masa për grumbullimin e të gjithë dokumentacionit në arkivin qendror të njësisë vendore, në përputhje me VKM-në nr. 510, datë 10.06.2015.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i zbatimit të punimeve, librit të masave, situacionit pjesor nr. 1 dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuar si dhe atyre të kryera në fakt, për objektin “Rindërtimi i terreneve sportive të shkollës “Mark Trothi”, ish poligoni, në qytetin Laç”, me vlerë të fondit limit 32,500,000 lekë pa TVSH, ku fitues është shpallur BOE “S.....A + E.....D”, u konstatua se për zërin e punimit “3.158/5a Transport me auto deri 5.0 km” (Seksioni punime prishje në territorin ekzistues) rezultuan se në zërin me nr. Analize 2.426/4 “Prishje shtresë betoni shkallët+bordura” është parashikuar që brenda çmimit të realizohej edhe nën zëri i “transportit”, dhe në këto kushte një zë punimi nuk mund të paguhet dy here përkatësisht në zërin 2.426/4 dhe në zërin 3.158/5a. Në situacion pjesor nr. 1 duhet të ishte likuiduar volumi 55 m³ transport [82 m³ – (25 m³ për zërin 2.426/4 + 2 m³ për zërin 2.426/5)] dhe jo volumi 82 m³ transport, duke shkaktuar një efekt negativ në vlerën 108,000 lekë pa TVSH (*Trajtuar gjerësisht në pikën (C), faqe 69-80, të Raportit Përfundimtar*).

8.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kurbin, nisur nga fakti se për objektin “*Rindërtimi i terreneve sportive të shkollës “Mark Trothi”, ish poligoni, në qytetin Laç*” punimet e ndërtimit janë në proces dhe brenda afatit të përfundimit, t’i kërkojë shoqërisë “S.....A” si përfaqësuese e BOE, të bëjë sistemimin e shumës prej 108,000 lekë pa TVSH si dhe të shumave të zërave të seksionit “punime prishje në territorin ekzistues” pa dubluar transportin.

Brenda periudhës së përfundimit të punimeve

9. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i zbatimit të punimeve në terren të kryera në fakt, librit të masave, situacionit përfundimtar, lidhur me volumet e punës të situacionuar, për kontratën me objekt “*Rikualifikim Urban i Bulevardit dhe i Qendrës së Qytetit Laç, Bashkia Kurbin. Loti I*”, lidhur me datë 20.12.2016 dhe me nr. prot. 4440/13, me OE zbatues “U.....M”, me vlerë të fondit limit 124,111,142 lekë pa TVSH, u konstatua këto problematika, gjatë periudhës së garancisë së defekteve të punimeve të ndërtimit: (Janë dëmtuar 12 pemë, që i përkasin zërit “F.V mbjellje pemë dekorative 16-18 cm” duke shkaktuar një efekt negativ në vlerën 192,000 lekë pa TVSH (12 x 16,000 lekë/pemë); Bllokime në punimet e drenazhimit në KUZ apo në KUB, shkaktuar nga mospastrimi i kanaleve; Kanë ndodhur çedime dhe deformime të pllakave të vendosura në bar (Grilone); Janë dëmtuar 2(dy) kosha metalik dhe ndërkohë ka filluar ndryshkja e tyre si dhe ndryshkje të rrjetave metalike) (*Trajtuar gjerësisht në pikën (C), faqe 69-80, të Raportit Përfundimtar*).

9.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (AK), Bashkia Kurbin, mbikëqyrësi i punimeve, si dhe grupi i marrjes në dorëzim si përfaqësues i autoritetit kontraktor të marrin masa që t’i kërkojnë zbatuesit të punimeve të ndërtimit realizimin e defekteve të konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, e në vijim të veprohet me kryerjen e kolaudimit përfundimtar të punimeve si dhe marrjen përfundimtare në dorëzim të objekteve të përfunduara sipas kontratës.

Brenda periudhës së përfundimit të garancisë së punimeve

10. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditit të Brendshëm Publik (NJAB) është miratuar me VKB nr. 18, datë 18.01.2018, dhe përbëhet nga dy punonjës të pa çertifikuar, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm Publik” neni 11 “*Punësimi i audituesit të brendshëm*” dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik”, pika 1.

Njësia e Auditit të Brendshëm (NJAB), për vitin 2017 nuk ka realizuar asnjë mision auditimi, kurse në vitin 2018 janë kryer në 4 misione auditimi, të llojit të kombinuar, duke audituar kryesisht lidhur me funksionimin e arkës dhe mbylljen e veprimeve financiare, mbajtjen e librit dhe ditarit të arkës, organizimi dhe funksionimin e sistemit të arkivë/ protokollit, ndihmën ekonomike dhe kriteret e përfitimit.

Në këto misione auditimi, ku njëri është në zbatim të rekomandimeve të KLSH, janë rekomanduar gjithsej 16 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 10 dhe në proces 6 masa. Nuk ka masa shpërblim dëmi.

Në lidhje me masat e rekomanduara nga KLSH për 17 masa shpërblim dëmi janë në proces zbatimi.

Konstatohet se, NJAB nuk ka kryer auditim në zonat me risk të lartë si: prokurimet me vlerë të vogël e vlerë të lartë, administrimi i aseteve, administrimin e taksave e tarifave vendore, etj. Gjithashtu në auditimet e ushtruara, NJAB nuk ka nxjerrje përgjegjësi dhe marrjen e masave disiplinore për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit (*Trajtuar gjerësisht në pikën (F) faqe 92-96, të Raportit Përfundimtar*).

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin, të marrë masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në përputhje me ligjin nr.114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditim e brendshëm publik”, dhe të përcaktojë personin përgjegjës për hartimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të riskut.

10.2. Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm, të marrë masa dhe të auditoi fushat me risk më të lartë, me qëllim paraqitjen e një panorame më të qartë të ecurisë së punës së kësaj Bashkie.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV” i ndryshuar, Inspektorati i Mbrojtjes Territorit (IMT) Bashkia Kurbin, ka marrë 28 vendime për prishjen e objekteve për ndërtimet pa leje, nga të cilat 7 vendime rezultojnë të ekzekutuara, kurse 21 vendime, rezulton se është mbajtur procesverbal konstatimi dhe prishjes, por nuk është marrë asnjë masë tjetër për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, në përputhje me përcaktimet ligjore (*Trajtuar gjerësisht në pikën (D) faqe 80-92, të Raportit Përfundimtar*).

11.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti, të vijojnë procedurë për vendosje penalteti për ndërtim pa leje dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, duke zbatuar vendimin e prishjes së objektit. Në rast kundërshtimi ndaj personave përgjegjës, të ndiqen procedurat ligjore deri në kallëzim penal ndajë shkelësve.

Në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 7 dosjeve të lejeve të zhvillimit të dhëna nga Drejtoria e PZHT, në 5 raste janë konstatuar shkelje të akteve ligjore e nënligjore, pasi në dosje mungonin procesverbalet e fillim/ ose përfundimit të punimeve sipas afateve të përcaktuara në lejen e zhvillimit, dhe nga Drejtoria e PZHT nuk janë zbatuar penaltet në masën 100,000 lekë për shkeljet e konstatuara. Gjithashtu për asnjë nga dosjet e audituara, nuk provohet se me përfundimin e lejes së zhvillimit, situacioni përfundimtar të jetë nënshkruar (vulosur), nga Drejtoria Rajonale Tatimore për të konfirmuar nëse është situacioni real (për efekt të rillogaritje së taksës së ndikimit në infrastrukturë), dhe nëse shoqëria ndërtues ka deklaruar si të ardhura në tatime ose jo (për efekt të TVSH dhe tatim mbi fitimin), veprime në kundërshtim me Neni 21, pika 2; nenet 40, 51 dhe 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” (*Trajtuar pikën (G), faqen 98-99, të Raportit Përfundimtar*).

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, Bashkia Kurbin, të marrë masa që në të gjitha rastet që konstatohet se leja e zhvillimit/ ose përfundimit nuk është brenda afateve të përcaktuara, të aplikohen penaltet sipas ligjit. Gjithashtu për asnjë rast lejet e zhvillimit dhe përdorimit të mos jepen pa plotësuar dokumentacionin e plotë tekniko – ligjorë.

12.2. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Kurbin, të marrë masa që në rastet e përfundimit të lejes së zhvillimit dhe kërkesës së subjektit për leje përdorimi, të kërkohet që situacioni përfundimtar i mbylles së punimeve të jetë i nënshkruar nga Administrata Tatimore për të konfirmuar vlerën e saktë të situacionit përfundimtar, dhe bërë të mundur llogaritjen e detyrimeve të taksës së ndikimit në infrastrukturë, nëse situacioni përfundimtar në vlerë nuk përputhet me preventivin e fillimit të punimeve.

Në vazhdimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të lartë, u konstatua se për procedurën me objekt: “*Rikualifikimin urban të bulevardit dhe sheshit qendrorë të qytetit Laç, Bashkia Kurbin, loti I*”, me fond limit 124,970,670 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “U.....M” me vlerë kontrate 124,111,142 lekë, nuk është kryer oponenta teknik të objektit me vlerë mbi 100 milionë lekë, veprim në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën (C) faqe 52-69, të Raportit Përfundimtar*).

13.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Kurbin, të marrë masa që në të gjitha rastet kur vlera e projekti që prokurohet është më e madhe se 100 milionë lekë, të kryhet oponenta teknike.

Në vazhdimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e aseteve të Bashkisë Kurbin, kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Kurbin dhe Njësive Administrative Mamurras, Milot dhe Fushë-Kuqe, konstatohet se është vepruar në kundërshtim me Kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi:

-Nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim, për rivlerësimin e tyre dhe përgatitjen e dokumentacionit për regjistrimin në ZVRPP dhe më pas në kontabilitet;

-Në kundërshtim me nenin 31/d, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik;

-Disa prona me sipërfaqe 49662 m², nga e cila 4800 m² sipërfaqe ndërtimi, , nuk janë lidhur kontrata qiraje, pavarësisht faktit që këto prona janë në përdorim nga persona të tretë për qëllime biznesi, duke çuar në mungesën e të ardhurave për Bashkinë Kurbin në vlerën **191,743,000 lekë**, në kundërshtim ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, Kapitulli III, pika 1/a, b(*Trajtuar gjerësisht në pikën (D), faqen 80-92, të Raportit Përfundimtar*).

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Pronave, të marrë masa për vijimin e punës duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (AKSH) dhe kontabilitet të pasurive të kaluara në pronësi.

14.2. Rekomandimi: Sektori i Menaxhimit të Pronave, të marrë masat për mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim, si dhe regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit, kontrata e qirasë, afati i vlefshmërisë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

14.3. Rekomandimi: Sektori i Menaxhimit të Pronave Bashkia Kurbin, të marrë masa për evidentimin e pronave të kaluar me VKM në pronësi të saj, dhe të kërkojë më rrugë ligjore lirimin e sendit ose të lidhë kontratat e qirasë për pronën e zaptuar nga të tretë, sipas *Aneksit D/1, bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit*, për të bërë të mundur saktësimin dhe realizmin e të ardhura të munguara në vlerën **191,743,000 lekë**, nga mos lidhja e kontratave të qirasë.

Brenda datës 30.09.2019

15. Gjetje nga auditimi: Në ekonominë Pyjore të Bashkisë Kurbin, kryejnë aktivitetet për shfrytëzim karriere 8 subjekte, të cilët kanë në përdorim 107.2 ha sipërfaqe pyjore/kullosore, të cilët nuk kanë lidhur kontratë për sipërfaqet që kanë në përdorim në vlerën 414,490 mijë lekë (periudha 2016 – 2018), në zbatim të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, duke krijuar mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë. Gjithashtu për këtë sipërfaqe nuk është bërë riklasifikimi i fondit pyjor/kullosor, veprim në papajtueshmëri me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me pikën 6, neni 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”, me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, ndryshuar dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në pikën (D), faqet 80-92, të Raportit Përfundimtar*).

15.1. Rekomandimi: Bashkia Kurbin nëpërmjet Agjencisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave (AAPK), t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorë të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

15.2. Rekomandimi: Agjencisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave (AAPK), të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme pyjore/kullorë nga kompanitë minerale, lidhjen e kontratave të qirasë, për të mundësuar realizimin e të ardhurave të munguara në interes të Bashkisë Kurbin me vlerë **141,490 mijë lekë**.

Brenda datës 30.09.2019

16. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i inventarit të materiale vetë Bashkisë Kurbin, u konstatua se kësaj njësie i është kaluar në pronësi “*Fusha e futbollit*” me adresë “Lagja Nr.4”, nr. pasurisë 4/477, ZK 2364, Indeks Harte H-4, lloji i pronës truall me sipërfaqe 8250 m², dhe godinë zhveshje me Nr. pasurie 4/483, ZK 2364, indeks harte H-4, lloji i pronës Truall ndertës me sipërfaqe trualli 105 m² dhe sipërfaqe ndërtese 77 m². Këto pasuri janë dhënë në përdorim shoqërisë “Klubit të Futbollit Laçi” SH.A, me Presidentit të Klubit P. L.

Referuar nenit 6 të akt-themelimit të shoqërisë, miratuar me Vendimin nr. 53 datë 22.04.2011 nga ish-Kryetari i Bashkisë Laç L. I, konstatohet se ndarja e aksioneve të kapitalit themeltar, ku ish- Bashkia Laç është kontribuues me 25% të aksioneve dhe shoqëria “Klubit të Futbollit Laçi” SH.A me president P. L. është kontribuues me 75% të aksioneve.

Konstatohet se në asnjë nen të akt-themelimit, nuk është përcaktuar mënyra se si Bashkia do të kontribuoj si aksionere, duke vepruar në kundërshtim me ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” kreu I, pika 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe kreun e II, pika 1 shkronja (a, b, c, ç, d, dh), pika 4, shkronja (a, b, c, ç, d, dh), si dhe kreu III pika 1 shkronja “a” të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për dhënien me qira ose enfeiteozë të pasurive shtetërore” ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.1, datë 23.01.2008 “ Për caktimin e çmimeve të qirasë së objekteve”, për dhënia në përdorim e pronës së bashkisë (si më sipër), për ushtrimin e aktivitetit, pa vendim të Këshillit të Bashkisë, pa konkurrim, pa lidhje kontrate qiraje dhe pa asnjë lloj dokumentacioni tekniko-ligjor mbi gjendjen fizike të fushës dhe godinës (*Më hollësisht trajtuar në pikën (D), faqe 80-92, të Raportit Përfundimtar*).

16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin me specialist të fushës, të marrë masa për lidhjen e kontratave për dhënien me qira të pasurisë “*Fusha e futbollit*” me adresë Lagja nr.4, Nr. pasurisë 4/477, ZK 2364, Indeks Harte H-4, lloji i pronës truall me sipërfaqe 8250 m² si dhe “Godinë zhveshje” Nr. pasurie 4/483, ZK 2364, indeks harte H-4, lloji i pronës Truall ndertës me sipërfaqe trualli 105 m² dhe sipërfaqe ndërtese 77 m², në pronësi të saj me shoqërinë “Klubit të Futbollit Laçi” SH.A, për shfrytëzimin e kësaj pasurie, dhe realizimin e të ardhurave në interes të Bashkisë Kurbin.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 511/10prot, datë 23.9.2016 janë dërguar rekomandimet për përmirësimin e gjendjes sipas Vendimit nr. 112, datë 23.9.2016 të Kryetarit të KLSH. Për masat e marra Bashkia Kurbin ka njoftuar KLSH-në me shkresën nr.3296 datë 13.10.2016 *brenda 20 ditëve nga dërgimi i rekomandimeve*. Gjithashtu me program auditimi nr. 1113prot, datë 4.11.2016 dhe autorizim nr. 1113/6prot, datë 4.11.2016 nga KLSH është audituar zbatimi i rekomandimeve të lëna, ku në përfundim të këtij auditimi disa nga rekomandimet kanë rezultuar të pazbatuara, për të cilën KLSH me shkresën nr. 1113/134prot, datë 31.01.2017 ka kërkuar Kryetarit të Bashkisë Kurbin rizbatimin e detyrave të pazbatuara.

Në auditimin e zbatimit të rekomandimeve sipas pikës (F) të programit të auditimit nr. 1267/1prot, datë 21.11.2018, është konstatuar se:

-Nga 22 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, janë zbatuar 20 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative;

-Nga 17 masa shpërblim dëmi me vlerë 16,178,821 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, janë në zbatuar 4 masa në vlerën 4,722,661 lekë, është në proces 1 masë në vlerën 258,668 lekë, nga e cila arkëtuar vlera 68,118 lekë dhe mbetet për arkëtim vlera 190,550 lekë dhe nuk janë zbatuar **30 masa për vlerën 10,530,736 lekë**.

-Në lidhje me masat disiplinore nga 16 masa janë zbatuar plotësisht 15 masa dhe nuk është zbatuar një masë;

-Nga 16 masa administrative, janë në proces 9 masa nga APP për vlerën 360,000 lekë janë zbatuar 5 masa për vlerën 250,000 lekë dhe nuk janë zbatuar 4 masa për vlerën 110,000 lekë dhe nga 7 masa nga IMTV-ja në vlerën 1,665,000 lekë, është arkëtuar vlera 665,000 lekë dhe në proces zbatimi vlera 1,000,000 lekë, veprim në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” dhe shkresën nr. 511/10, datë 23.9.2016 “Për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Kurbin”, shprehur në Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 112, datë 23.9.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (F) faqe 96-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 242/4, datë 09.05.2016, rikërkuar me shkresën nr. 511/10, datë 23.9.2016 dhe nr. 1113/134, datë 31.01.2017, respektivisht:

a- Për masa organizative, pikat: 2;6;7;8;9;

b- Për masa shpërblim dëmi, pikat 2;3;4;5;7;8;9;10;11;12;13 dhe 14 në vlerën **10,721,286 lekë**.

c- Për masat administrative në vlerën **1,110,000 lekë**.

Brenda datës 30.09.2019

18. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në Bashkinë Kurbin për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.01.2016 -31.12.2018, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 e nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

Në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak

B. MASA SHPËRBILM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -*Të drejtat e KLSH*, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e demit në vlerën **7,218,185lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i zbatimit të kontratës nr. 5125/14, datë 26.12.2017 për vlerën 9,612,697 lekë, të punimeve, librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuar si dhe atyre të kryera në fakt, në objektin “*Rikonstruksion i pjesshëm i godinës së Bashkisë Laç (pjesa I)*”, rezultuan diferenca në volume dhe punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga AK si dhe specifikimet teknike, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **723,900 lekë pa TVSH**. Sa më sipër nuk është në zbatim nenin 8, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, Pika 3 si dhe me kontratën e lidhur me datë 26.12.2017 me nr. prot. 5125/14 *(Më hollësisht trajtuar në pikën (C) faqe 69-80, të Raportit Përfundimtar).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës ne bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Kurbin te marre masa për shpërblimin e demit rezultuar si diferenca ne volume dhe punime te pakryera ne vlerën **723,900 leke** nga shoqëria, “**P.....I**”, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën datë 26.12.2017 me nr. prot. 5125/14.

Brenda datës 30.09.2019

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i zbatimit të kontratës nr. 2224/16, datë 6.7.2018 për vlerën 6,812,400 lekë, të punimeve, librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuar si dhe atyre të kryera në fakt, në objektin “*Riparim rrugësh të paasfaltuara, Bashkia Kurbin*” rezultuan diferenca në volume dhe punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **398,000 lekë pa TVSH**. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me nenin 8, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, me Udhëzimin e KM Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, Pika 3 si dhe me kontratën e lidhur me datë 06.07.2018 dhe nr. prot. 2224/16 (*Më hollësisht trajtuar në pikën (C) faqe 69-80, të Raportit Përfundimtar*).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës ne bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Kurbin te marre masa për shpërblimin e demit rezultuar si diferenca ne volume dhe punime te pakryera ne vlerën **398,000 lekë**, nga shoqëria “**L.....I**”, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën datë 06.07.2018 dhe nr. prot. 2224/16.

Brenda datës 30.09.2019

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i zbatimit të kontratës nr. 2195/15, datë 20.06.2017 për vlerën 7,859,400 lekë të punimeve, librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuar si dhe atyre të kryera në fakt, në objektin “*Rinovim Trotuari në Qytetin e Laçit, Bashkia Kurbin*” rezultuan diferenca në volume dhe punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **178,455 lekë pa TVSH**. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me nenin 8, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, me Udhëzimin e KM Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, Pika 3 si dhe me kontratën e lidhur me datë 06.07.2018 dhe nr. prot. 2224/16 (*Më hollësisht trajtuar në pikën (C) faqe 69-80, të Raportit Përfundimtar*).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës ne bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Kurbin te marre masa për shpërblimin e demit rezultuar si diferenca ne volume dhe punime te pakryera ne vlerën **178,455 lekë**, nga shoqëria “**K.....A**”, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën datë 20.06.2018 dhe nr. prot. 2195/15.

Brenda datës 30.09.2019

4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit të procedurës me objekt “*Rindërtim i terreneve sportive të shkollës “Mark Trokthi”, ish- poligoni në qytetin Laç*”, me vlerë të fondit limit 32,500,000 lekë pa TVSH, ku fitues është shpallur BOE “**S.....A + E.....D**” për vlerën e kontratës 32,190,747 lekë pa TVSH, konstatohet se në ofertën e paraqitur është rënduar padrejtësisht TVSH e zbritjes së makinerive/ pajisje, duke krijuar një dëm në buxhetin e Bashkisë Kurbin për vlerën **30,730 lekë**, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu VI “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”, shkronja (a), VKM nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8 dhe UKM nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin NR. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, shkronja (c) (*Trajtuar gjerësisht në pikën (C) faqe 69-80, të Raportit Përfundimtar*).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridikë Bashkia Kurbin, të marrin masa për nxjerrjen debitorë dhe arkëtimin e vlerës prej **30,730 lekë**, për TVSH e makinerive/pajisjeve nga shoqëria “S.....A”, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën datë 13.8.2018 dhe nr. prot. 2843/15.

Brenda datës 30.09.2019

5. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se nga zyra përkatëse nuk është krijuar një regjistër i posaçëm për mbajtjen e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti. Nga krahasimi me faqen online të QKB-së, u konstatua një diferencë e madhe në numrin e subjekteve që kanë objekt aktiviteti tregtinë e hidrokarbureve dhe derivateve të tyre, si karburant ose si lëndë djegëse. Nga auditimi i lejeve përkatëse të tregtimit dhe pagesave të tyre, u konstatua se si nga ish-komunat dhe ish-bashkitë, por edhe pas konsolidimit, vazhdimisht është aplikuar në mënyrë të gabuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet për vlerën **5,600,000 lekë**, e paarkëtuara dhe e llogaritur gabim për tarifën e pajisjes me autorizimet për tregtim të karburanteve dhe lëndëve djegëse për popullatën, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kurbin, në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” (Trajtuar më hollësisht në pikën (B), faqet 45-52, të Raportit Përfundimtar).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e taksave e Tarifave Vendore, Bashkia Kurbin, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **5,600,000 lekë** (sipas Tabelës B/10 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit ndaj debitorëve. Gjithashtu, të verifikojë të gjithë subjektet që tregtojnë karburante dhe të aplikojë tarifën për pajisjen me leje/autorizim tregtimi ose të pezullojë aktivitetin deri në pajisjen me lejen/autorizimin e nevojshëm për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, lëndëve djegëse.

5.2. Rekomandimi: Bashkia Kurbin të marrë masa për të krijuar një regjistër të posaçëm për këtë kategori biznesesh, por edhe regjistra të tjerë, për bizneset e tjera me natyrë specifike (si p.sh. subjekte që paguajnë rentën minerare, që përdorin pasuritë publike për grumbullimin e bimëve medicinale, peshkimin, etj.).

Brenda datës 30.09.2019

6. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Kurbin është konstatuar se me datë 27.09.2004 ish- Bashkia Mamurras në vendimin nr. 79, datë 24.09.2004 ka miratuar një Akt-marrëveshje për “*menaxhimin e tregut të lirë të qytetit Mamurras*”.

Në datë 04.01.2011 është bërë ratifikimi i Akt-marrëveshjes ndërmjet pronarit të ligjshëm H. S sipas certifikatës së pronësisë nr. 146237 serie dhe nr. pasurie 140/1 lëshuar nga ZVRPP- Kurbin me datë 27.05.2009 dhe Kryetari i Bashkisë D. N, mbështetur në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 1 datë 23.01.2008 “Për caktimin e nivelit të çmimit të qirasë së tregut”. Sipas pikës 4 të akt-marrëveshjes fitimi nga të ardhurat e tregut do të ndahen 49% bashkia dhe 51% subjekti, por në fakt kjo akt-marrëveshje nuk është zbatuar duke lidhur një kontratë qiraje sipas VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, në kundërshtim me kushtet e akt-marrëveshjes.

Aktualisht rezulton se megjithëse kontrata ka përfunduar, personi qiramarrës nuk ka dorëzuar objektin të cilin ka vazhduar ta posedojë, gëzojë dhe disponojë, pa kryer pagesën e qirasë sipas kontratës, nga data 31.12.2017 e në vazhdim, Në nenin 815, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil”, citohet: “*Qiramarrësi që është në vonesë për të kthyer sendin, detyrohet t’i japë qiradhënësit pagesën e caktuar deri në dorëzim, përveç detyrimit për të shpërblyer dëmin përkatës*”. Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion, deklarimeve verbale dhe sipas mandatpagesave të bëra nga H. S në vitin 2018, detyrimi për periudhën 01.01.2018-31.12.2018, nuk është paguar nga H. S dhe përlllogaritja e dëmit nga mos pagesa e qirasë është në vlerën 288,000 lekë (24.000 x 12 muaj), e ardhur e munguar në Bashkinë Kurbin (Trajtuar gjerësisht në pikën (D), faqen 80-92, të Raportit Përfundimtar).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtorinë Juridike Bashkia Kurbin, të marrë masa për zbatimin e plotë të kushteve të kontratës, duke i kërkuar subjektit “Haxhi Sula”, pasqyrat financiare (bilancet) nga momenti i lidhjes së saj deri në fund të vitit 2018, për të evidentuar fitimi nga aktivitet tregtarë, dhe për të bërë të mundur arkëtimin e pjesës së fitimit prej 49% siç është përcaktuar në akt-marrëveshje, duke zbritur pjesën e qirasë së paguar në vite.

6.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtorinë Juridike Bashkia Kurbin, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e qirasë së papaguar në vlerën **288,000 lekë**, për vitin 2018.

Brenda datës 30.09.2019

B/I. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të regjistrimit të realizimit të prokurimeve me vlera të larta për periudhën objekt auditimi 01.01.2016 – 31.12.2018, konstatohet se janë kryer gjithsej 66 procedura me vlerë të fondit limit prej 868,875,846 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 833,969,980 lekë ose 96% e vlerës së fondit limit.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës duke marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 2% për investimet/shpenzime, ku niveli i precizionit të materialitetit paraqitet në vlerën 4,971 mijë lekë (për vitin 2016), në vlerën 7,268 mijë lekë (për vitin 2017) dhe në vlerën 6,908 mijë lekë (për vitin 2018), nga 64 procedura me vlerë kontrate 587,535,555 lekë ose 94% e vlerës së kontratave të lidhura, auditori me zgjedhje 39 procedura me vlerë kontrate të lidhur prej 550,455,653 lekë ose 89% e vlerës së kontratave.

Në totalin e procedurave të audituara (39) me vlerë kontrate 550,455,653 lekë, rezulton se në 9 procedura me vlerë kontrate prej 66,238,200 lekë ose 12 % e kontratave të audituar, janë konstatuar parregullsi në shpalljen fitues të OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST, ku procedurat përputhen formalisht me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për prokurimin publik, pasi KVO nuk është udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, sigurimit të dobishmërisë së përdorimit të fondeve publike, të cilat do të krijonin mundësinë e shpalljes fitues të OE me ofertë ekonomike më të leverdishme midis operatorëve pjesëmarrës, veprime këto në paligjshmëri të procedurave të prokurimit për vlerën **2,645,935 lekë**, veprime në paligjshmëri të procedurave të prokurimit, veprime në paligjshmëri të procedurave të prokurimit, dhe në kundërshtim me kërkesat në nenin 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, shkronja (a, b, d, dh), nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, shkronja (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime, veprime në paligjshmëri të procedurave të prokurimit, dhe në kundërshtim me kërkesat në nenin 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, shkronja (a, b, d, dh), nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, shkronja (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime (Trajtuar më hollësisht në pikë (C), faqe 52-69, të Raportit Përfundimtar).

1.1 Rekomandimi: Bashkia Kurbin, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike për vlerën **2,645,935 lekë**, duke mos u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, nëpërmjet shmangies së arsyeve të skualifikimit të operatorëve ekonomik të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi (01.01.2016 – 31.12.2018), me procedura me vlerë të vogël janë realizuar gjithsej 222 procedura për vlerën 46,346,058 lekë, nga të cilat janë audituar 108 procedura me vlerë 36,031,349 lekë ose 77.7% e vlerës së kontratave të lidhura. Nga procedurat e audituara, në 7 procedura me vlerë kontrate prej **2,099,450 lekë**, janë konstatuar parregullsi, pasi dokumentacioni që e shoqëron nuk është sipas dispozitave ligjore, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike të prokuruar, dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “ Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Kreu I, neni 1, pika 2(a) , pika 2 (b), neni 23, pika 4, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 2, neni 4, pika 19, pika 26, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 36; Urdhri nr. 33, datë 11.07.2013 “Për Gjurmët Standarde të Auditimit për Prokurimin me vlera të vogla dhe të lartë” (*Trajtuar më hollësisht në pikë (A), faqe 34-37, të Raportit Përfundimtar*).

2.1. Rekomandimi: Bashkia Kurbin, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve me vlerë të vogël për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në paligjshmëri dhe përdorimin e fondeve publike për vlerën **2,099,450 lekë**, duke mos u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin.

Brenda datës 30.09.2019

B/II. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Kryetari i Bashkisë Kurbin*, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e të ardhurave të munguara në **vlerën 110,710,081 lekë**, si më poshtë:

-vlera 107,155,081 lekë, mos arkëtimin të vlerës së borxhit tatimor (taksa dhe tarifa), nga subjektet private dhe abonentët familjarë.

-vlera 3,555,000 lekë, mos arkëtimin të vlerës së gjobave të aplikuara nga IMTV, Bashkia Kurbin.

Në mënyrë më të detajuar gjetjet janë paraqitur si vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2017, në zërin “*Të drejta të arkëtushme nga të tretë*”, paraqitet në vlerën zero, duke mos pasqyruar në to detyrimet e borxhit për taksat e tarifatat vendore të subjekteve fizik/juridik dhe abonentët familjarë në vlerën **107,155,081 lekë**, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kurbin, *konkretisht:*

Nr.	Emërtesa	Vlera detyrimi
1.	Taksa e Tokës	37,701,506
2.	Abonentët familjarë	20,419,118
3.	ALUIZNI	28,535,422
4.	Bizneset	20,499,035
	<i>Nga e cila:</i>	
	<i>Gjoba të vitit 2017</i>	<i>411,536</i>
	<i>Detyrim papaguar periudha 2011-2018</i>	<i>18,170,515</i>
	<i>Kamatëvonesë 0.06% në 365 lekë</i>	<i>1,916,984</i>

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Pika 1 e nenit 3 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve

dhe rregullave kontabël” pjesa e parë, “Rregulla të përgjithshme” kapitulli i parë, “Mbajtja e kontabilitetit”; UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njëjsteve që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”; Ligji nr. 33-2017, “Për shuarjen e detyrimeve tatimore”; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në pikën (B), faqet 45-52, të Raportit Përfundimtar*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore në Bashkinë Kurbin, të marrë masat për kontabilizimi e detyrimeve të papaguara të taksave/tarifave vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë deri në fund të vitit 2018 për vlerën **107,155,081 lekë**, si dhe zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e tyre, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore RSH”.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”, të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

e- Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me 3 Njësitë Administrative, *respektivisht: Milot, Mamurras dhe Fushë Kuqe*, të evidentojë listat emërore të debitorëve në mënyrë elektronike dhe të printuar dhe në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 98³, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave vendore, të verifikojë detyrimet, kamatëvonesat dhe gjobat për subjektet debitorë për periudhën përpara vitit 2014, nëse këto detyrime janë prekur nga Ligji nr. 33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore”.

Brenda datës 30.09.2019

2. Gjetje nga auditimi: Nga Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Bashkia Kurbin janë vendosur 13 gjoba në vlerën 3,555,000 lekë për ndërtim të paligjshëm, vlerë e cila nuk është shpallur titull ekzekutiv. Nga kjo vlerë është në proces gjyqësor vlera prej 1,205,000 lekë dhe nuk është arkëtuar akoma vlera 2,350,000 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Kurbin, veprime në kundërshtim me: Nenin16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime;

Nenin15-(*Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr.9794, datë 23.7.2007, neni 1*)(*Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr.9826, datë 1.11.2007, neni 2*)(*Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10324, datë 23.9.2010, neni 3*);

Nuk janë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobës) të përcaktuara në nenet, 9,22 dhe 30, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet

³Të gjitha Njësitë e vetëqeverisjes vendore të marrin masat e nevojshme për zbatimin e kërkesës ligjore, për njoftimin paraprak të detyrimit tatimor të miratuar me vendim të Këshillit Vendor, për gjithë tatimpaguesit (familjarë dhe biznese në territorin përkatës)

administrative”.

Nga Sektori Juridik, nuk është kërkuar në Gjykatë, kthimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative”.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike nuk ka marrë masat dhe nuk ka kërkuar në Gjykatë rivendosjen në afat për 23 vendime me gjobë për ndërtimet e pa ligjshme, të vendosura për periudhën 2016-2018 në vlerën **3,555,000 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996, ”Kodi i Procedurës Civile në RSH“ i ndryshuar, nenet 17 dhe 55- Vënia në ekzekutim, shkronja dhe nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”

Gjithashtu nga IMTV janë mbajtur dhe 4 (katër) vendime “*Për Prishje Objekti*”, por që nuk është vendosur gjobë dhe nuk është marrë asnjë masë e mëtejshme për shkeljen e konstatuar (ndërtim pa leje), duke favorizuar në mënyrë të jashtëligjshme personat përgjegjës për mos penalizim të tyre në vlerën prej **2,000,000 lekë**, në kundërshtim me nenin 52, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, *respektivisht*:

Shtetasit **M. D**, me adresë lagja “Lester” fshati Selit Njësia administrative Milot, nuk është vendosur asnjë gjobë në masën **500,000 lekë**, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

Shtetasin **P. M** banues në fshatin fushë Milot Njësia administrative Milot, nuk është vendosur asnjë gjobë në masën **500,000 lekë**, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

Shtetasin **F. M** banues në fshatin Patok, Njësia administrative Fushë-Kuqe, nuk është vendosur asnjë gjobë në masën **500,000 lekë**, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

Shtetasit **A. N**, me adresë lagja “Nr. 4 Rruga Nacionale Laç”, dhe nga IMT-ja, nuk është vendosur asnjë gjobë në masën **500,000 lekë**, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera (*Trajtuar pikën (D), faqen 88-92, të Raportit Përfundimtar*).

2.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “*Kodit Procedurës Civile në RSH*”, të marrin masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për vendimet me gjobë për ndërtimet e kundërligjshme, të vendosura për periudhën 2016 -2018 në vlerën **3,555,000 lekë**, (*duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” i ndryshuar*). Njëherazi të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv (*Sipas Pasqyrës që administron IMTV Bashkia Kurbin*).

2.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Kurbin, të marrë masat për zbatimin e akteve administrative ndaj **4 personave** që kanë kryer ndërtim pa leje në territorin e Bashkisë Kurbin për vendosjen e penalitetet në vlerën **2,000,000 lekë**, dhe të ndiqen të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës nga personat përgjegjës: M. D, P. M, F. M dhe A. N për vlerën **500,000 lekë secili**.

Brenda datës 30.09.2019

C. MASA ADMINISTRATIVE:

C/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt-konstatimet nr. 7, 8 dhe 9, datë 31.01.2019 (Bashkia Kurbin), vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenet 15 shkronja (c, ç) dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me

shkeljet e konstatuara, apo t'i rekomandojë Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për **4 (katër) punonjës**, si më poshtë:

Për 4 anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

1. G. D me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë Kurbin, në cilësinë e Kryetarit të KVO.

2. E. P me detyrë Drejtor Finance, në cilësinë e anëtarit të KVO **në 4 (katër)** procedura prokurimi, *respektivisht*:

a-Në tenderit me objekt “Sistemimi me çakëll i rrugëve te pa asfaltuara te Bashkisë Kurbin”, me fond limit 4,166,667 lekë pa TVSH.

b-Në tenderit me objekt “Skema ujitëse e fushës se Milotit, Mamurrasit, Drojës, Bashkia Kurbin, kanalet dytësore (U-1202, U-1203 U-1204 U-1205 U-1211 U-1213(pjesërisht) të U-12, viti 2017”, me fond limit 13,748,190 lekë pa TVSH.

c-Në tenderit me objekt “Lyrje e institucioneve arsimore, Bashkia Kurbin, viti 2017”, me fond limit 6,664,367 lekë pa TVSH.

ç-Në tenderit me objekt “Rikonstruksion i pjesshëm i godinës së Bashkisë Laç (pjesa i-^{rë}), viti 2017”, me fond limit 10,190,600 lekë pa TVSH.

3. A. R me detyrë ish- Specialiste në Sektorin e Urbanistikës., në cilësinë e anëtarit të KVO, në **3 (tre)** procedura prokurimi, *respektivisht*:

a-Në tenderit me objekt “Sistemimi me çakëll i rrugëve te pa asfaltuara te Bashkisë Kurbin”, me fond limit 4,166,667 lekë pa TVSH.

b-Në tenderit me objekt “Skema ujitëse e fushës se Milotit, Mamurrasit, Drojës, Bashkia Kurbin, kanalet dytësore (U-1202, U-1203 U-1204 U-1205 U-1211 U-1213(pjesërisht) të U-12, viti 2017”, me fond limit 13,748,190 lekë pa TVSH.

c-Në tenderit me objekt “Lyrje e institucioneve arsimore, Bashkia Kurbin, viti 2017”, me fond limit 6,664,367 lekë pa TVSH.

4. J. C me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve Publike, në cilësinë e anëtarit të KVO **në 1 (një)** procedura prokurimi, *respektivisht*:

a-Në tenderit me objekt “Rikonstruksion i pjesshëm i godinës së Bashkisë Laç (pjesa i-^{rë}), viti 2017”, me fond limit 10,190,600 lekë pa TVSH.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në procedurat e mësipërme, duke pasur parasysh se, KVO-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE/BOE e tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, është konsideruar mos përmbushje e kërkesave në DST, gjykojmë se vendimet e marra nga KVO për shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), duke mos anuluar këto procedura, veprime të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të 70,033,408 lekë, me efekt financiar në vlerën 2,645,935 lekë, të llogaritur si diferencë e vlerave të ofertave ekonomike të operatorëve me mangësi dhe OE të shpallu fitues me mangësi në dokumentacion, duke mos vlerësuar kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, në kundërshtim me neni 1- “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, shkronja (c, ç, d, dh), neni 2-“Parimet e përzgjedhjes”, neni 24-“Anulimi i një procedure prokurimi”, neni 53- “Shqyrtimi i ofertave”, neni 55- “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, si dhe neni 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.(Trajtuar më hollësisht në pikën (C) faqet 55-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe akt-konstatimet nr. 7, 8 dhe 9, datë 31.01.2019)

D. MASA DISIPLINORE:

D/1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, geramat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr.

152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kurbin që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH –së, për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2018, të fillojnë procedurat për dhënien për 7 (shtatë) punonjësve, si më poshtë:

a. “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, neni 58 shkronja (b).

1. E. P. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Mangësitë e konstatuara në miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2017, ku janë evidentuar mangësitë si vijon:

Mos analizimin dhe kontabilizimin e llog. 202-*Studime e projekte*”.

Mos paraqitje në llog. 231-*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*, të vlerës së investimeve të papërfunduara dhe regjistrimi i vlerës së tyre në llog. 212-*Ndërtime e konstruksione* apo llog. 213-*Rrugë, rrjete, vepra ujore*, pa përfunduar investimi.

Mos kontabilizimi i detyrimeve të paarkëtueshme nga taksat e tarifave vendore në vlerën 49 milionë lekë.

- Mos marrjen e masave për likuidimin e faturave të palikujduara në fund të periudhës sipas radhës dhe vitit të krijimit dhe krijimi i faturave të reja, pa mundësuar pagesën e faturave të prapambetura.

-Nuk ka marrë masa të mjaftueshme për planifikimin dhe realizimin e buxhetit vjetor, duke lejuar diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit. Nuk ka bërë të plotë analizat e punës për realizimin e buxhetit paraardhës, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë viteve të audituara.

2. R. K me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Kontabilitetit, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare viti 2017.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Mangësitë e konstatuara në miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2017, ku janë evidentuar mangësitë si vijon:

Mos analizimin dhe kontabilizimin e saktë të llog. 202-*Studime e projekte*”.

Mos paraqitje në llog. 231-*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*, të vlerës së investimeve të papërfunduara dhe regjistrimi i vlerës së tyre në llog. 212-*Ndërtime e konstruksione* apo llog. 213-*Rrugë, rrjete, vepra ujore*, pa përfunduar investimi.

Mos kontabilizimi i detyrimeve të paarkëtueshme nga taksat e tarifave vendore në vlerën 49 milionë lekë.

-Për mangësitë e konstatuara në procedurat e blerjeve me vlera të vogla, pasi dokumentacioni që e shoqëron nuk është sipas dispozitave ligjore, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike të prokuruar, konkretisht urdhër shpenzimet.

3. A. B me detyrë Drejtor i Planifikimit të të Ardhurave.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Mos mbajtje e akt-rakordimeve me agjentët tatimorë. Mungesë informacioni të saktë dhe të plotë për gjendjen financiare të bashkisë, për pritshmërinë nga të ardhurat që duhet të sigurohen nga agjentët tatimorë dhe rrjedhimisht mos bërje në mënyrën e duhur dhe të plotë të parashikimeve buxhetore. Mos krijimi i bazave të të dhënave dhe paqartësi e personelit në lidhje me bazën ligjore të posaçme për këto kategori të ardhurash.

-Mos evidentim i subjekteve me veprimtari tregtare speciale, mos aplikim në formën dhe në vlerën e duhur i tarifave për këto kategori subjektësh.

-Mos grumbullimi në bashki i dokumentacionit për pagesën e taksës së tokës dhe mos pasqyrimi në kontabilitet i vlerave të debitorëve për këtë taksë.

-Mos zbatimin e masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifave vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë, për vlerën 107 milionë lekë.

4. A. S me detyrë specialist finance në Drejtorinë e Financës, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare viti 2017.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Mangësitë e konstatuara në miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2017, ku janë evidentuar mangësitë si vijon:

Mos analizimin dhe kontabilizimin e saktë të llog. 202-*Studime e projekte*”.

Mos paraqitje në llog. 231-*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*, të vlerës së investimeve të papërfunduara dhe regjistrimi i vlerës së tyre në llog. 212-*Ndërtime e konstruksione* apo llog. 213-*Rrugë, rrjete, vepra ujore*, pa përfunduar investimi.

Mos kontabilizimi i detyrimeve të paarkëtueshme nga taksat e tarifave vendore në vlerën 49 milionë lekë.

5. L. N me detyrë Drejtor i Bujqësisë, Mjedisit dhe Turizmit.

Për shkeljet e mëposhtme:

Mos grumbullimi në bashki i dokumentacionit për pagesën e taksës së tokës.

Mungesë informacioni të saktë dhe të plotë për gjendjen e tokave, trojeve dhe sipërfaqeve të tjera në pronësi të qytetarëve apo bizneseve, për të cilat duhet të vilen taksat/tarifave përkatëse. Mos krijimi i bazave të dhënave dhe paqartësi e personelit në lidhje me bazën ligjore të posaçme për këto kategori të ardhurash.

- Mos identifikimi i saktë i pronave dhe mos marrja e masave për regjistrimin e tyre në ZVRPP në zbatim të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe në mbështetje të Pikave 9, 10, 11 dhe 22 të VKM nr. 500, datë 14.8.2001.

- Mos zbatim i Urdhrin nr. 13 datë 20.01.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kurbin, për verifikimin e pronave të paluajtshme që transferohen ose janë në përdorim të Bashkisë Kurbin, deri në regjistrimin e tyre pranë ZVRPP-së”.

b-“Vërejtje”, neni 58 shkronja (a).

1. M. L me detyrë specialiste në Sektorin e arsim Kulturës, dhe

2. L. K me detyrë specialist në Sektorin e Terreneve Sportive, në cilësinë e anëtarëve të komisionit BVV.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për mangësitë e konstatuara në procedura të blerjeve me vlera të vogla, pasi dokumentacioni që e shoqëron nuk është sipas dispozitave ligjore, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike të prokuruar, konkretisht urdhër shpenzimet.

D/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas kodit të punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat (e, ç) e neni 1, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” dhe shkronja (b) e neni 9- “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kurbin**, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH –së, për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2018, të fillojnë procedurat për dhënien masë disiplinore për **15 (pesëmbëdhjetë)** punonjësve të mëposhtëm:

a-Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës

1. D. P me detyrë Administrator Njësia Administrative Milot.

2. K. SH me detyrë Administrator Njësia Administrative Mamurras.

3. K.M me detyrë Administrator Njësia Administrative Fushë Kuqe.

Bazuar ne ligjin nr.139/2015 dt.17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, neni 66-Detyrat e administratës së njësisë administrative, shkronja (b), ku përcaktohet se : “Mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin, mban përgjegjësi administratori i Njësisë administrative Milot, Fushë Kuqe dhe Mamurras”:

Për shkeljet e mëposhtme:

- Mos identifikimi i saktë i pronave dhe mos marrja e masave për regjistrimin e tyre në ZVRPP në zbatim të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe në mbështetje të Pikave 9, 10, 11 dhe 22 të VKM nr. 500, datë 14.8.2001.

- Mos zbatim i Urdhrin nr. 13 datë 20.01.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kurbin, për verifikimin e pronave të paluajtshme që transferohen ose janë në përdorim të Bashkisë Kurbin, deri në regjistrimin e tyre pranë ZVRPP-së”.

4. B. P me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit:

Për shkeljet e mëposhtme:

Për mos marrjen e masave në zbatim të procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet pa leje dhe të certifikuara nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, për sipërfaqen totale 175,949 m² me vlerë 28,535,422 lekë.

5. D. P me detyrë Specialistë e Aseteve.

6. F. L me detyrë Topograf në Drejtorinë e Bujqësisë.

7. B. K me detyrë Specialist në Drejtorin e Financës.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Mos identifikimi i saktë i pronave dhe mos marrja e masave për regjistrimin e tyre në ZVRPP në zbatim të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe në mbështetje të Pikave 9, 10, 11 dhe 22 të VKM nr. 500, datë 14.8.2001.

- Mos zbatim i Urdhrin nr. 13 datë 20.01.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kurbin, për verifikimin e pronave të paluajtshme që transferohen ose janë në përdorim të Bashkisë Kurbin, deri në regjistrimin e tyre pranë ZVRPP-së”.

8. E. M me detyrë Përgjegjësi i Agjencisë së Kullimit dhe Vaditjes.

9. S. K me detyrë Drejtor i Agjencisë së Kullimit dhe Vaditjes.

10. N. Ç me detyrë specialist në Agjencinë e Mirëmbajtjes së Rrugëve.

11. A. M me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të PZHT.

12. M. L me detyrë specialiste në Sektorin e arsim Kulturës, dhe

13. A. T me detyrë specialist në Sektorin e Terreneve Sportive, në cilësinë e anëtareve të Komisionit të Blerjeve me Vlera të Vogla.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për mangësitë e konstatuara në procedurat e blerjeve me vlera të vogla, pasi dokumentacioni që e shoqëron nuk është sipas dispozitave ligjore, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike të prokuruar, konkretisht urdhër shpenzimet.

14. E. A me detyrë përgjegjësi në Agjencinë e Pyjeve.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Ka vepruar në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me pikën 6, neni 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kulloror”, me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e

kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, ndryshuar dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullor”, të ndryshuar, dhe VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.

15. J. M me detyrë K/Inspektor i IMT-së.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për objektet e ngritura nën territorin e Bashkisë Kurbin IMT, për mos zbatim të VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV” i ndryshuar, pasi nuk është e dokumentuar procesi i kontrollit të ushtruar për zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi, duke mos vlerësuar ka një vlerësim të shkeljeve të punimeve në ndërtim”.

D/3. Për 9 punonjës të Bashkisë Kurbin, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2016 dhe 2017, respektivisht: *S. T, R. V, P. M, B.B dhe L. T (për aktivitetin e vitit 2016) dhe T. K kryetar dhe anëtarët T. S, B. A, A. N (për aktivitetin e vitit 2017)*, të cilët aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune në Bashkinë Kurbin, të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për disa të meta e mangësi në ndjekjen e procedurave për inventarizimin dhe daljen jashtë përdorimit të aktiveve, por që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative, për arsye se asnjëra prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave, nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasoja të konsiderueshme në mirëfunksionimin e institucionit, konsiderojmë që për to të mos propozohet masë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R